



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I INXHINIERIT HIDROTEKNIK
ANTARËT E URDHRIT/ASAMBLEJA KOMBËTARE

DRAFT

PLANI I STRATEGJISË DHE MENAXHIMI I RISKUT



PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut të brendshëm të Urdhrit.

KAPITULLI I PARE

Parashtrimi i ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit (i ndryshuar).

Neni 1	Objekti i ligjit
Neni 3	Fusha e zbatimit të ligjit
Neni 5	Menaxhimi financiar dhe kontrolli
Neni 8	Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit
Neni 11	Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të NjVK-së
Neni 19	Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit

PERKUFIKIME

STRUKTURAT E NJESIVE PUBLIKE

Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme NjQV

Njësi e Vartësisë së Kontrolluara NjVK

KAPITULLI I DYTE

ROLET DHE AKTORËT NË SISTEMIN E MFK-së

Përgjegjshmëria menaxheriale

Titullarët e Njësive Publike

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Roli i Auditimit të Brendshëm

Aktiviteti i AB në Urdhër

Roli i Auditimit të Jashtëm (Asambleja Kombëtare)

Marrëdhëniet institucionale publike dhe ndikimi i tyre në menaxhimin financiar dhe kontrollin

KAPITULLI I TRETE

KOMPONENTET E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Referuara nenit 19, Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Neni 20 Mjedisi i kontrollit

Neni 21 Menaxhimi i riskut

Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit

Neni 23 Informacioni dhe komunikimi

Neni 24 Monitorimi

Neni 18 Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm

KAPITULLI I KATERT

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TE RISKUT TE ENTIT PUBLIK

- I. DEKLARATA E POLITIKES SE MENAXHIMIT TE RISKUT
- II. QELLIMI I POLITIKES SE MENAXHIMIT TE RISKUT
- III. PERMBUSHJA E QELLIMEVE
- IV. ECURIA E PROCESIT TE MENAXHIMIT TE RISKUT
- V. DETYRIMET QE LIDHEN ME REALIZIMIN E POLITIKES SE MENAXHIMIT TE RISKUT
- VI. PROCEDURA KUADËR PËR MENAXHIMIN E RISKUT TË BRENDSHËM

SKEMA E MENAXHIMIT TE RISKUT

VII. METODOLIGJIA QE PERDORET NE REALIZIMIN E PROCEDURES KUADER

- 1) HARTIMI I PLANIT VJETOR TE PUNES SE URDHROT
- 2) EVIDENTIMI I FUSHAVE KRYESORE TE VEPRIMIT NE URDHROTIN E INXHINIERIT HIDROTEKNIKE
Objektivi Nr. 1 deri ne 8
- 3) IDENTIFIKIMI I ZONAVE TE RISKUT NE KUADER TE FUSHAVE TE VEPRIMTARISE
 - 1) risqe të brendshme dhe risqe të jashtme;
 - 2) risqet në nivel subjekti dhe në nivel detyrash.
- 4) PERKUFIZIMI DHE PERSHKRIMI I RISKUT
- 5) ANALIZA E IMPAKTIT TE RISKUT
- 6) PERCAKTIMI I PROBABILITETIT QE RISKU TE NDODH

- 7) PERGJIGJA NDAJ RISKUT
VLERËSIMI I RISKUT
- 8) CAKTIMI I DETYRAVE KONKRETE LIDHUR ME KUNDERVEPRIMIN NDAJ NJE
LLOJI TE CAKTUAR RISKU
- 9) KRIJIMI I HARTES SE RISKUT
FORMULAR PËR VLERËSIMIN E RISKUT
VLERËSIMI I RISKUT
- 10) MONITORIMI DHE RAPORTIMI

DISPOZITA MIRATUESE

HYRJA NE FUQI

NDRYSHIMI I AKTIT

REZULTATI I VOTIMIT



HYRJA

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut të brendshëm të Urdhrit.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknike ne RSH, kjo metodë do të përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar mbi risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e Urdhrit me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive të zhvillimit të qëndrueshëm në kryerjen e shërbimeve. Në zbatim të plotë të Ligjit Organik si edhe të Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit (i ndryshuar).

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik konsideron se për të qenë efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës së Urdhrit dhe të integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës si edhe të vete punës në kryerjen e shërbimeve të vete inxhinierëve dhe nuk duhet parë si një program i shkëputur. Në vijim, menaxhimi i risqeve duhet të bëhet përgjegjësi e çdo inxhinieri hidroteknik si edhe çdo punonjësi dhe përfaqësuesve të Urdhrit, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut fokusohet si në risqet e nivelit strategjik ashtu dhe në zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm të disiplinës së hidroteknikës.

Qëllimi i Strategjisë është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës të çdo inxhinieri hidroteknik, nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen çdo hidroteknik, shoqëria shërbimi, Enti Publik, si edhe të japë ndikimin e zvogëlimit të riskut në të gjithë skemat e menaxhimit të shërbimeve në fushën e veprimtarisë së Disiplinës së Hidroteknikës.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknike në RSH jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun në Entit Publik. Ajo synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

KAPITULLI I PARE

Parashtrimi i ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010

Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit (i ndryshuar).

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik RSH është ent publik dhe ushtron funksione specifike të qeverisjes qendrore në baze dhe zbatim të ligjit ORGANIK, dhe ligjeve të tjera koherente të zbatueshme. Për të menaxhuar sa më me efikasitet, efektivitet dhe me ekonomi burimet financiare publike, si edhe njerëzore, në respekt të parimeve të transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe për shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë intelektuale dhe financiare, dhe do të bazohemi në ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit (i ndryshuar).

Neni 1 Objekti i ligjit

Ligji përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin.

Neni 3 Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet në njësitë publike, ku përfshihen:

1. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
2. Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme.
3. Njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare

Neni 5 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëritë shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Neni 8 Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit

1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

4. Në rast moskaktimi të nëpunësit autorizues, përgjegjshmëria menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit, i takojnë titullarit të njësisë publike.

6. Titullarët e njësive publike, drejtuesit e strukturave, që zbatojnë detyra që lidhen me shpenzimin apo menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian, ose kryejnë funksionin e organeve ndërmjetëse të këtyre fondeve, përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të rregulloreve përkatëse të Bashkimit Evropian.

8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

- a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave;*
- c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit;*
- d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe;*
- dh) rregullimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë funksionale të tij;*
- e) futjen e procedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi;*
- ë) sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.*

Neni 11 Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të NjVK-së

Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të NjVK-ve janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

1. Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që drejtojnë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional.
2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.

Neni 19 Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Me sipër u prekën disa nga nenet e ligjit MFK-se, që janë baze për menaxhimi e Njësive publike, por ne zbatim duhet te kryhen te gjitha procedurat e ligjit.

PERKUFIZIM

Fonde Publike" janë të gjitha fondet, përfshirë edhe fondet e Bashkimit Evropian dhe të donatorëve të tjerë, të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen e shpenzohen nga Urdhri apo shoqëritë e shërbimeve hidroteknike dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grandet etj., sipas legjislacionit.

Identifikim i riskut; identifikimi i ngjarjeve të cilat nëse ndodhin do të kenë ndikim negativ në arritjen e objektivave të veprimtarisë në disiplinën e Hidroteknikes.

Kontrolli i brendshëm financiar publik (KBFP); është tërësia e sistemit të kontrollit të brendshëm që ushtrohet nga Enti Publik, për të garantuar se menaxhimi financiar dhe kontrollit të (Urdhrit si edhe Njësive Vartëse të Kontrolluara), që është në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe me parimet e menaxhimit financiar me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi. Kontrolli

i brendshëm financiar publik përfshin të gjitha veprimtaritë, me qëllim kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve të Urdhrit. Ai, gjithashtu, përfshin harmonizimin qendror dhe koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe të auditimit të brendshëm.

Menaxherë dhe/ose administratorët janë të gjithë personat që ushtrojnë funksione menaxheriale dhe që mbajnë përgjegjshmëri menaxheriale në NjQP-ne dhe te NjVK-ve.

Oreksi për Risk, një seri kufijsh, të autorizuar në mënyrë të përshtatshme nga skema e menaxhimit, që i jep secilit nivel të drejtën dhe detyrën të qarta mbi limitet e riskut që ato mund të marrin, ose një mundësi dhe kostot e përpjekjes për ta shfrytëzuar atë shërbim.

Përgjegjshmëria menaxheriale; është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera.

Risk; është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësive.

Titullar i njësisë publike; Në kuptim të ligjit MFK, titullar i njësisë publike, që drejtohen me organe vendimmarrëse kolegjiale, konsiderohet Kryesia e urdhrit.

Titullar i njësisë; në Shoqëritë Tregtare konsiderohet organi përgjegjës për përcaktimin e politikave të shoqërisë sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në kuptim të ligjit MFK-se.

Vlerësim i riskut; është procesi i vlerësimit të riskut lidhur me impaktin nëse një risk ndodh dhe mundësisë që risku të ndodhë.

Shënim;

çdo përkufizim i pa përcaktuar me lartë apo që del i domosdoshëm për shprehje, referojuni ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit (i ndryshuar), si edhe ligjit Organik.

STRUKTURAT E NJESIVE PUBLIKE

Njësi e Qeverisjes se Përgjithshme NjQV; do të quhet Enti Publik urdhri i inxhinierit hidroteknike i krijuar me ligj, i cili ka të drejtë për të ushtruar funksione specifike në nivel qeverisjeje qendrore, si edhe menaxhon fonde publike.

Referuar ligjit organik çdo person juridik dhe fizik që kryejnë shërbime në fushën e veprimtarisë së hidroteknikes ka Funkcion Publik, në vijim do të quhen me termin Njësi e Vartësisë së Kontrolluara prej urdhrit. Në mënyrë grafike



Njësi e Vartësisë së Kontrolluara NjVK; *njësi* do të quhen të gjithë personat juridik dhe fizikë që kryejnë shërbime në fushën e veprimtarisë së hidroteknike dhe të regjistruar dhe certifikuar nga urdhri; **vartësi e kontrolluar** shpreh lidhjen kohezive që është ligji organik dhe që kontrollon evazionin profesional dhe evazionin fiskal që ushtrohet nëpërmjet kontrollit të brendshëm (KBFP).

KAPITULLI I DYTE

ROLET DHE AKTORËT NË SISTEMIN E MFK-së

Përgjegjshmëria menaxheriale

Baza për një sistem efikas të kontrollit të brendshëm në njësitë publike është llogaridhënia menaxheriale. Sipas Ligjit për MFK-në, drejtuesit e njësive publike kanë detyrimin të zbatojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe legjitimitetin në administrimin e fondeve publike dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me to.

Titullarët e Njësive Publike

Titullarët e njësive publike të (NjQV dhe të NjVK), do janë përgjegjës për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave, identifikimin në të gjitha nivelet e njësisë të risqeve që kanë ndikim në përmbushjen e tyre, dhe për krijimin e një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të MFK-së në përputhje me kërkesat e ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve. Titullarët e njësive janë përgjegjës përpara Urdhrit për monitorimin dhe vlerësimin në kohën e duhur të sistemit të MFK-së, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për MFK-në.

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë dhe ose të autorizuarve të tyre.

GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike. GMS luan një rol kyç për sa i takon integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike dhe deontologjisë.

Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Roli i Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm është një aktivitet i pavarur, objektiv që jep siguri dhe këshilla dhe është i projektuar për t'i shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e Urdhrit. Ai i vjen në ndihmë njësisë të arrijë objektivat e veta, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve qeverisëse të njësisë. Një njësi e pavarur e AB ofron garanci dhe jep rekomandime në mënyrë që i gjithë sistemi i MFK-së të funksionojë me efektivitet.

Aktiviteti i AB në Urdhër

Është të ndihmojë që kryesia dhe njësitë e tjera të vendimmarrëse, të mbajnë përgjegjësi para publikut duke vlerësuar dhe matur pajtueshmërinë me ligjet në fuqi dhe rregulloret, kontrollet, efikasitetin, ekonominë dhe efektivitetin e operacioneve. AB është pjese e strukturës së ekzekutivit të urdhrit.

Roli i Auditimit të Jashtëm (Asambleja Kombëtare)


Sistemi i MFK dhe cilësia e funksionimit të tij duhet të jenë po ashtu subjekt i auditimit të jashtëm, apo i vlerësimit të pavarur nga Urdhri, që përgjigjet para Asamblesë Kombëtare, në cilësinë e tij si përfaqësues i Anëtarëve të Urdhrit. AJ-ja informon dhe diskuton rregullisht me Asamblenë Kombëtare për aktivitetet e veta si dhe gjetjet e auditimit dhe mund të propozojë ndryshime ligjore, që synojnë përdorimin më me efektivitet të burimeve buxhetore, Referuar Ligjit Organik.

Marrëdhëniet institucionale publike dhe ndikimi i tyre në menaxhimin financiar dhe kontrollin

Një përjasje gjithëpërfshirëse dhe integrale në zhvillimin e MFK-së të strukturës publike kërkon marrjen parasysh të faktit se njësitë publike janë të ndërlidhura dhe se kjo ka ndikim në zhvillimin e MFK-së në tërësi.

Me poshtë është figura e ndërlidhur që përfshin njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme NjQV që është Urdhri me strukturat përkatëse në varësi të saj, të ngritura me qëllim trajtimin e aktiviteteve të caktuara

nga fusha e kompetencës së përkatëse. Gjithashtu, shembulli i Njësive të Vartësisë së Kontrolluara NjVK që janë subjektet që kryejnë shërbime në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës të certifikuar nga urdhri.



Lidhja e urdhrat dhe subjekteve të shërbimit në kuadër të MFK-së

Në kuadër të sistemit të MFK-së çdo njësi publike është i detyruar për të mbledhur informacionin e duhur në mënyrë që të sigurojnë një konsolidim të MF.

Ndërlidhja e këtyre institucioneve buron nga marrëdhëniet që lidhen me, zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve të disiplinës së Hidroteknike, konsolidimin e buxheteve dhe pasqyrave financiare, si dhe lidhjet e tyre në kuadrin e objektivave strategjike të Urdhrit të inxhinierit Hidroteknikë.

KAPITULLI I TRETE

KOMPONENTET E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Referuara nenit 19, Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

Neni 20 Mjedisi i kontrollit

1. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

2. Mjedisi i kontrollit përmban:

- a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;
- b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës;
- c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
- ç) politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- d) aftësitë profesionale të punonjësve.

➤ Integriteti dhe vlerat etikes dhe deontologjisë janë elementë thelbësorë që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të mirë kontrolli. Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre.

Ata duhet të kuptojnë se besnikëria ndaj këtyre vlerave mund të ndihmojë njësinë në arritjen e objektivave të saj. Detyrat e Inxhinierëve hidroteknike dhe nën specialistëve plotësueses janë të

pasqyruara ne rregullat e shkruara ne Kodin e Etikes dhe Deontologjisë se inxhinierit hidroteknike si edhe në statut dhe norma te tjera te miratuara nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.

- Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësive qe menaxhojnë. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxiti kompetencën dhe sjelljen etike dhe deontologjinë. Angazhimi personal dhe shembulli vetjak që shfaq titullari i njësisë publike, e krijojnë “modelin nga lart” dhe inkurajojnë punonjësit të respektojnë me ndërgjegjshmëri kontrollet ekzistuese.
- Filozofia dhe stili i menaxhimit mund të demonstrohen në fusha të tilla si:
 - Mënyra se si identifikohen dhe reagohe ndaj risqeve (si të brendshme, ashtu edhe të jashtme);
 - Pranimit i kontroleve rregullatore të vendosura nga të tjerët;
 - Qëndrimi kundrejt raportimit të brendshëm dhe të jashtëm;
 - Zbatimi i parimeve të kontabilitetit;
 - Qëndrimi i Menaxhimit ndaj teknologjisë së informacionit dhe funksioneve kontabël;
 - Mbështetja që jep Menaxhimi dhe gatishmëria që tregon për t’iu përgjigjur vlerësimeve dhe auditimeve të jashtme dhe të brendshme.
- Titullarët e njësisë NjQP-se NjVK-ve qe janë persona publike duhet të :
 - Mbështesë kontrollin e brendshëm dhe të vendosin rregulla dhe procedura të qarta dhe të përshtatshme si dhe të monitorojë zbatimin e tyre;
 - Të mbajë rregullisht takime me menaxherët operacionalë;
 - Të krijojë dhe të ruajë kushtet për zhvillimin e AB, i cili do të raportojë drejtpërdrejt tek Titullari i njësisë publike.
- Qëndrimi mbështetës është një predispozitë që nxiti rezultatet e pritshme. Meqenëse menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm i jep menaxhimit garanci të arsyeshme se misioni i njësisë do të përmbushet, menaxhimi duhet të ketë një qëndrim mbështetës ndaj kontrollit të brendshëm që përshkon tej për tej njësinë.

Menaxheri duhet t'i japë tonin një sjelljeje që thekson rëndësinë e kontrollit të brendshëm. Ky ton duhet të karakterizohet nga:

- Mbështetja për të kryer kontrollet e vetëvlerësimit dhe auditimet e jashtme dhe të brendshme;
- Gatishmëria për të marrë në konsideratë çështjet e ngritura nga auditimet, apo nga vlerësimet;
- Edukimi i vazhdueshëm për të garantuar se të gjithë e kuptojnë sistemin e kontrollit të brendshëm dhe rolin që kanë në të;
- Theksimi i parimeve të ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës me fondet publike.

- Titullari i çdo njësie publike duhet të ngrejë një strukturë organizative që të bëjë të mundur arritjen e objektivave dhe të jetë në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. Struktura organizative është korniza me anë të cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Struktura duhet të jetë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme.

Struktura e njësisë duhet të përfshijë:

- Rregulla të qarta që përcaktojnë ndarjen e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësi, duke përfshirë rregullat për delegimin e tyre;
- Një hierarki të përshtatshme;
- Linja të qarta raportim

Struktura e njësisë:

- Duhet të reflektohet në një dokument (akt administrativ) të shkruar, ose rregullore të brendshme që u vihet në dispozicion të gjithë punonjësve;
- I bëhet e ditur të gjithë anëtarëve të stafit dhe t'i ndihmojë ata të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta dhe vendin që ato zënë në njësi;
- Mund të paraqitet në formë të ilustruar nëpërmjet një grafiku (organigrame), që tregojë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta;
- Vendos një sistem të përshtatshëm për delegimin e detyrave aty ku është e nevojshme;
- Duhet të vendosë linja të përshtatshme raportimi

- Profesionalizmi është një karakteristikë e Inxhinierëve hidroteknik që nënkupton se ai ka aftësinë, dijen dhe zotësinë e duhur për të kryer detyrat që i ngarkohen. Sa mirë duhet të kryhen këto detyra është përgjithësisht një vendim i titullarit, i cili duhet të vendosë mbështetur në objektivat e njësisë si dhe në strategjitë e politikave që ai ka përcaktuar për përmbushjen e këtyre objektivave
- Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për;
- Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune;
 - Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës;
 - Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta;
 - Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.
 - Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve;
 - Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit të vlerësimit.
- Titullari i njësisë delegon kompetenca ose detyra të anëtarëve të caktuar të stafit, sipas objektivave dhe detyrave të njësisë. Fusha e kompetencave dhe detyrave të deleguara dhe masa e deleguar duhet të jenë të përshtatshme për shkallën e rëndësisë së vendimeve që duhet të merren dhe nivelin e riskut të lidhur me to.

Neni 21 Menaxhimi i riskut

1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.
2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.

Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

Vendosja e objektivave

Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike duhet të drejtohet nga titullari dhe t'u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë. Të gjitha njësitë publike (drejtoritë dhe departamentet) duhet të zhvillojnë objektivat e tyre dhe t'i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë. Këto objektiva të vendosura tregojnë qartësisht atë që njësia synon të arrijë dhe se si do të matet ecuria.

Të gjithë objektivat duhet të jenë të shkruara. Menaxherët e njësive publike duhet të sigurojnë objektivat e shkruar organizative dhe operacionale bashkë me deklaratën e misionit. Titullarët e njësive publike duhet të sigurohen se punonjësit i kuptojnë objektivat dhe se si puna e tyre ndihmon në arritjen e objektivave.

1. Objektivat janë të pasqyruara me poshtë në pikën - EVIDENTIMI I FUSHAVE KRYESORE TE VEPRIMIT NE URDHRIN E INXHINIERIT HIDROTEKNIKE.
2. Njësia publike duhet të specifikojë dokumentet e planifikimit, duke përfshirë një përshkrim të objektivave në nivel strategjik dhe operacional dhe për të përcaktuar se çfarë do të jetë bazë për përcaktimin e nivelit të riskut të njësive publike – kapitulli i mëposhtëm STRATEGJIA E MENAXHIMIT TE RISKUT TE ENTIT PUBLIK tregon rrugën.

Procesi i menaxhimit të riskut

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e shërbimeve të përditshme të veprimtarisë që kryen çdo njësi. Menaxhimi i riskut mund të thuhet se është po aq i zhvilluar sa janë edhe aktivitetet e kontrollit. Aktivitetet e kontrollit përqendrohen jo vetëm në çështjet e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, por edhe në çështje që lidhen me dhënien e sigurisë së objektivave të vendosura do të arrihen. Vlen të theksohet se risqet janë të pashmangshme në operacionet e përditshme. Prandaj, përdoruesit e buxhetit duhet të ndërmarrin veprime adekuate për të qenë në gjendje për të justifikuar se cili është niveli i pranueshëm i riskut që ata janë të gatshëm të ndërmarrin.

Në këtë kapitull kemi diskutuar tre element të menaxhimit të riskut:

- Identifikimi i ngjarjes;
- Vlerësimi i riskut;
- Përcaktimi i reagimit ndaj riskut.

Strategjia e Riskut

Çdo NjQP dhe NjVK duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut që përditësohet rregullisht (çdo tre vjet) ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme. Strategjia duhet të përgatitet nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknike në cilësinë e përfaqësuesit të anëtarëve të urdhrorit. Titullari i njësisë miraton strategjinë e menaxhimit të riskut, analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit.

Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit

1. Titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. vazhdon lexo ligjin.

- Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësive dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësive duhet të marrin parasysh përfitimin që pritët prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efektive.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë;

- Të përshtatshme (kontrolli i duhur në vendin e duhur në nivelin e duhur dhe në përpjesëtim me riskun e përfshirë);
- Efektive nga pikëpamja e kostos (kostot për vënien në zbatim të kontrollit nuk duhet t'i tejkalojnë përfitimet);
- Të gjithanshme, të kuptueshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektivat e kontrollit;

- Të dokumentuara qartë;
- Në përputhje me planin e zbatimit të tyre për një periudhë të caktuar

Kategoritë e aktiviteteve të kontrollit

Aktivitetet e kontrollit shërbejnë si mekanizma për arritjen e objektivave dhe janë pjesë e rëndësishme e arritjes së këtij qëllimi. Ato mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Kontrolle parandaluese ose para faktit,;
- Kontrolle zbuluese ose pas faktit;
- Kontrolle drejtuese ose menaxheriale.

Plani i Kontrollit të Brendshëm

Plani i Kontrollit të Brendshëm është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen.

Kontrollet duhet të sigurojnë:

- Autorizimet
- Përputhshmërinë ligjore
- Ndarjen e detyrave
- Plotësinë
- Efikasitetin & Efektivitetin

Nivelet e Kontrollit të Brendshëm

- Titullari i Institucionit: përcakton Planin e Kontrollit;
- Niveli qendror i kontrollit: ekzekuton Planin;
- NjVK-te : përcaktojnë Planin e Kontrollit të përshtatshëm për strukturën e tyre;

Neni 23 Informacioni dhe komunikimi

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë. lexo ligjin.

- Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të

të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet ...

- Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë.

Neni 24 Monitorimi

1. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet.

2. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm nuk është pjesë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Funksioni i auditimit të brendshëm rregullohet me ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

- Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efikente me kalimin e kohës.
- Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet:
 - Monitorimit të vazhdueshëm;
 - Vetëvlerësimit;
 - Auditimit të brendshëm.

Neni 18 Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm

- Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të

brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji

- Çdo Nëpunës i autorizuar (ose titullari i një njësie publike në qoftë se nuk ka NA) për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë ("Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm" në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, NA i njësisë publike (ose titullari i njësisë ku nuk ka NA) duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Secili titullar njësie/NA do të nënshkruajë personalisht dhe vendosë datën në deklaratë, në të cilën ai/ajo:

- a. merr përsipër përgjegjësinë për menaxhimin efikas të burimeve financiare dhe jofinanciare të cilat janë në dispozicion të njësisë së tij/saj;
- b. pranon se sistemi i kontrollit të brendshëm, duke qenë i vendosur në njësinë e tij / saj siguron përdorimin e ligjshëm dhe efikas të burimeve.

Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- c. Një përshkrim të kuadrit të riskut dhe kontrollit brenda njësisë, përfshirë veprimet e ndërmarra ose të propozuara për të trajtuar çdo çështje të rëndësishme të kontrollit.

Deklarata duhet të depozitohet te NPA në fund të muajit Shkurt si dhe duhet të jetë një element i raportit vjetor të performancës dhe objekt i shqyrtimit nga ana e AB të njësisë publike dhe nga KLSH.

KAPITULLI I KATERT

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TE RISKUT TE ENTIT PUBLIK

I. DEKLARATA E POLITIKES SE MENAXHIMIT TE RISKUT

I pranojmë parimet e mëposhtme të Politikës së Menaxhimit të Riskut të Brendshëm të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknike në RSH, si edhe pranojmë t'i përdor këto parime si orientime për politikën e brendshme të menaxhimit të riskut edhe në Subjektin (Njësi e Vartësisë së Kontrolluara NjVK), që do të punojmë dhe kryejmë shërbime në fushën e veprimtarisë së Hidroteknike.

II. QELLIMI I POLITIKES SE MENAXHIMIT TE RISKUT

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot shoqërore dhe financiare në minimumin e domosdoshëm.

Minimizimi dhe menaxhimi i riskut dhe më tej eliminimi apo reduktimi i pranueshëm është një domosdoshmëri në të gjitha aktivitetet e shërbimeve të fushës së inxhinierisë hidroteknike, pasi këto risqe japin ndikime negative në shoqëri, që janë kundër mbrojtjes së interesit publik, të sigurisë, të shëndetit, apo të zhvillimit ekonomik.

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknike në RSH nëpërmjet kësaj Strategjie, angazhohet të sigurojë që rreziqet identifikohen dhe trajtohen në kohën e duhur.

Parimet e mëposhtme të Politikës së Menaxhimit të Riskut në Entin Publik pranohen të përdoren si orientime për politikën e brendshme dhe të tregut në shërbime, të menaxhimit të riskut në Urdhër. Parimet përdoren dhe si ndikim në zvogëlimin e riskut gjatë kryerjes së shërbimeve nga inxhinieret hidroteknike.

III. PERMBUSHJA E QELLIMEVE

Përmbushja e qëllimeve realizohet nëpërmjet:

- 1) Ngritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të Inxhinierëve Hidroteknike, lidhur më çështjet e menaxhimit të riskut.
- 2) Përkufizimit të fushave të riskut dhe të detyrave delikate në veprimtarinë e Disiplinës së Hidroteknikës.

- 3) Monitorimit të qëndrueshëm i fushave të riskut.
- 4) Ndërmarrjes së masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.
- 5) Nxitja dhe inkurajimi për të edukuar dhe rritur numrin e inxhinierëve hidroteknike, duke pasur parasysh edhe përfaqësimin gjinore.

IV. ECURIA E PROCESIT TE MENAXHIMIT TE RISKUT

- ❖ Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut janë të lidhura ngushtë me realizimin e qëllimeve të Urdhrit.
- ❖ Menaxhimi i riskut është një prej elementëve të ciklit të planifikimit dhe të marrjes së vendimeve.
- ❖ Përkufizimi i të gjitha fushave të riskut.
- ❖ Përdorimi i një metodike të unifikuar në identifikimin dhe analizën e riskut.
- ❖ Përdorimi i një metodike të unifikuar për raportimin e riskut.
- ❖ Funksionimi i procesit të vlerësimit dhe të kundërveprimit ndaj pasojave të riskut, që përfshijnë të gjithë inxhinierët hidroteknik, që janë Anëtarë të Urdhrit.
- ❖ Kufizimi i riskut nëpërmjet marrjes në kohën e duhur të masave të përshtatshme korrigjuese dhe riparuese.
- ❖ Analiza e riskut është një proces i vazhdueshëm.

V. DETYRIMET QE LIDHEN ME REALIZIMIN E POLITIKES SE MENAXHIMIT TE RISKUT

Realizimi i politikës së menaxhimit të riskut përfshin disa parakushte të cilat përbejnë një detyrim që lidhet me implementimin e suksesshëm të saj, të cilat janë:

- 1) Detyrim i Inxhinierëve Hidroteknike dhe Drejtuesve të Urdhrit është monitorimi dhe verifikimi periodik i risqeve që kërcënojnë realizimin e qëllimeve kryesore strategjike dhe veçanërisht të skemës së menaxhimit.
- 2) Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për identifikimin e riskut dhe për vlerësimin e tij, d.m.th. Hidroteknik të Nivelit të Pare.
- 3) Punonjësit kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.


- 4) Çdo veprim i inxhinierit hidroteknik i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun do të vlerësohet dhe sipas gjykimit të mbështetet nga Drejtuesit e Urdhrit.
- 5) Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo Inxhinieri Hidroteknik.

VI. PROCEDURA KUADËR PËR MENAXHIMIN E RISKUT TË BRENDSHËM

Me qëllim garantimin e realizimit të politikës së menaxhimit të riskut, vendoset procedura kuadër e menaxhimit të riskut. Mënyra e përshkruar më poshtë, do të jetë mënyra e veprimit në procesin e menaxhimit të riskut të brendshëm:

- Hartimi i Planit Vjetor të Punës të Njesisë së Shërbimit,
- Evidentimi i fushave themelore të funksionimit të Njesisë së Shërbimit,
- Identifikimi i zonave të riskut në kuadër të fushave të veprimit të përcaktuara,
- Përkufizimi dhe përshkrimi i këtyre risqeve,
- Vlerësimi i impaktit të një risku të caktuar,
- Përkufizimi i probabilitetit që një risk i caktuar të ndodhë,
- Përgjigja ndaj riskut – masa parandaluese, duke përfshirë ato që tashmë janë zbatuar dhe ato që janë të domosdoshme në të ardhmen (të planifikuara), Skema e menaxhimit të shërbimit;
- Caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për llojin e shërbimit,
- përgatitja e hartës/regjistrit të riskut,
- monitorimi dhe raportimi.

SKEMA E MENAXHIMIT TE RISKUT



VII. METODOLIGJIA QE PERDORET NE REALIZIMIN E PROCEDURES KUADER

1) HARTIMI I PLANIT VJETOR TE PUNES SE URDHRI

Përgatitja e draftit përfundimtar të planit të punës për vitin pas ardhës, si edhe miratimi nga Këshilli Kombëtar duhet të përfundojë jo më vonë se date 31 Tetor i vitit paraardhës.

Lidhur me punën për vitin në fjalë të përcaktuara në Vendimin aktual paraardhës, deri në këtë çast duhet të punojë mbështetur në projektin e planit të punës për vitin në fjalë, deri në përfundim të vitit pararendës. Plani vjetor do të marrë parasysh detyrat kryesore si dhe treguesit e vlerësimit të njësive, të përcaktuara në Vendimin, detyrat që burojnë nga dispozitat ligjore, rekomandimet dhe porositë e dala pas kontrollit etj., si dhe do të përfshijë të gjitha sferat më të rëndësishme të funksionimit të Urdhrit.

Detyrat e përcaktuara në planin e punës do të jenë të përgjithshme në masën e duhur, si dhe do të përmbajnë qëllime të qarta dhe të lexueshme (sasiore, tregues dhe kuota), si dhe do të përmbajnë afatin e realizimit të tyre dhe emërtimet e njësive dhe emrat e punonjësve konkretë që janë përgjegjës për realizimin e tyre.

2) EVIDENTIMI I FUSHAVE KRYESORE TE VEPRIMIT NE URDHRIN E INXHINIERIT HIDROTEKNIKE

Në zbatimin e komponentëve të Menaxhimit të Riskut, Urdhri i Inxhinierit Hidroteknike ka në konsideratë qëllimin e përgjithshëm të zhvillimit të veprimtarisë së Disiplinës së Hidroteknikës në të gjitha nivelet e shërbimeve që kryejnë inxhinieret hidroteknike si edhe të vete institucionit të Entit Publik. Gjithashtu janë marrë në konsideratë dhe disa iniciativat dhe projekte të së ardhmes.

Në Planin Strategjik të Zhvillimit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknike, ka një analizë të hollësishme të mjedisit strategjik ku Urdhri nëpërmjet Inxhinierëve Hidroteknike kryen dhe parashikohet të kryejë veprimtarinë në të ardhmen. Njëkohësisht ky Plan përcakton drejtimet kryesore drejta zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarive të Disiplinës së Hidroteknikës. Misioni, vizioni dhe vlerat janë pjesa e rëndësishme e Strategjisë, të cilat mbështesin objektivat strategjike të Urdhrit si më poshtë:

Objektivi Nr. 1.

Zhvillimi i Veprimtarisë Administrative të Entit Publik të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik në RSH-se, në përputhje me standardet vendase, ndërkombëtare dhe praktikën e mira Evropiane.

- A. Veprimtaria Administrative do të funksionojë sipas skemës së menaxhimit të urdhrit me organet përfaqësueses, vendimmarrëse dhe ekzekutive të nivelit Kolegjial.
- B. Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendase dhe lidhja me Entet përfaqësueses të vendeve të tjera, përfshirë edhe lidhjen kohezive me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës.
- C. Zhvillimi dhe Konsolidimi i Komunikimit përmes Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i IT në kryerjen e shërbimeve të Urdhrit.

Objektivi Nr. 2.

Rritja e kapaciteteve të shërbimeve të veprimtarisë së disiplinës së Hidroteknikës, në përputhje me nevojat e shërbimeve në treg dhe me standardet e sigurisë dhe shëndetit dhe zhvillimit ekonomik.

- A. Urdhri do të ndikojë në zhvillimin e kapaciteteve teknike nëpërmjet përcaktimit të detyrave të skemave të menaxhimit të çdo shërbimi duke përcaktuar edhe detyrën specifike të çdo lloji.

- B. Njëpërmjet vetëqeverisjes urdhri do të miratojë buletinet, manualët, metodat dhe rregullat teknike të detyrueshme për zbatim të projekteve të zhvillimit dhe administrimit të fushës së veprimtarisë së hidroteknikës, si edhe të promovojë standarde të reja;
- C. Ndikim në siguri, njëpërmjet të drejtës së certifikimit të të dhënave dhe matjeve brenda fushës së veprimtarisë së hidroteknikës, si edhe ushtron të drejtën e matjeve, analizave dhe vlerësimit si edhe ekspertizës teknike;

Objektivi Nr. 3.

Urdhri do të zhvillojë edukim të vazhdueshëm profesional gjatë karrierës dhe do të sigurojë mundësi për zhvillim profesional për ata inxhinierë/specialist dhe nën specialist që ka nën mbikëqyrje, si edhe vlerëson performancën e inxhinierëve dhe specialistëve që ka nën mbikëqyrje.

- A. QTPH-ja do të ofrojë veprimtari mësimore dhe trajnuese, me ngarkesë përkatësisht 10 deri 30 kredite (ECTS), që finalizohen me lëshimin e certifikatave profesionale dhe vlerësimin e krediteve përkatëse, kjo vlerë i shtohet pagës minimale reference (bruto), sipas parashikimeve në ligj. Do të kryejë edhe trajnime profesionale për përfitimin e titullit “Certifikatës Profesionale të Urdhrit”
- B. Individët (specialistët dhe nën specialistët) që punojnë në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës mund të kualifikohen dhe kategorizohen për aftësitë e fituara gjatë punës së tyre në nivele vlerësimi për të cilët pajisen me dëshmi profesionale nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.
- C. Urdhri do të kryejë trajnime dhe testime për reagimin ndaj emergjencave, sipas programeve dhe moduleve të miratuara më parë, si edhe në zbatim të ligjit për mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë për këtë qëllim. Urdhri do të kryejë trajnime dhe testime në dy nivele, të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknik, si edhe të nivelit specialist dhe nën specialist plotësues që punojnë në veprimtarinë hidroteknike, sipas përcaktimeve të ligjit.
- D. Me kërkesë të të interesuarit urdhri njëpërmjet QTPH-se dhe KEGjDP-se do të hartojë performancën e çdo inxhinieri, specialisti dhe nën specialisti që punon në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.

Objektivi Nr. 4.

Urdhri ka të drejtën e certifikimit të profesionisteve të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknikë, si edhe ushtron të drejtën e vlerësimit, kategorizimit dhe pajisjes me dëshmi profesionale të specialisteve të nivelit jo inxhinier që punojnë në fushat e veprimtarisë së hidroteknikës.

- A. Çdo inxhinier hidroteknik mund të punoj pa asnjë kufizim në fushat e veprimtarisë së disiplinës së hidroteknikës, inxhinieri e ushtron shërbimin për ato aftësi për të cilin është certifikuar me pare nga urdhri.
- B. Inxhinieret do të kualifikohen në Nivele, këto nivele do të përcaktohen nga numri dhe lloji i trajnimeve dhe kufizimeve ligjore dhe nënligjore që do të harmonizohen nga urdhri.
- C. Inxhinieret Hidroteknike të kualifikuar, certifikuar dhe me eksperiencë do të trajnojnë dhe testojnë dhe me pas vlerësojnë specialistet dhe nën specialistet plotësues.

Objektivi Nr. 5.

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik në RSH nëpërmjet vendimeve të Asamblesë Kombëtare synon rritjen e vlerësimit financiar të çdo inxhinier hidroteknike, specialist apo nën specialist plotësues, si edhe të shoqërive të tyre që do të ushtrojnë shërbime. Shpërblimi i Pagës Bruto të Inxhinierit Hidroteknik, si edhe të vlerës se tarifave të shërbimeve me qëllim për të kryer punë efektive dhe cilësore minimalisht vlerësohet.

- A. Nëpërmjet bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave, me propozimin e ministrit që administron çështjen e financës dhe të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, përcakton pagën minimale referuese të nivelit të inxhinierit hidroteknik.
 - 1) Niveli i III-të (tretë): Individ i në momentin e përfitimit të titullit Inxhinier Hidroteknik i lind e drejta të kërkojë dhe do të paguhet minimalisht me pagën (bruto), si edhe përfiton nga çdo punëdhënës fee, për të drejtën e përdorimit të titullit Inxhinier Hidroteknike, përkatësisht shumen prej 10.000 leke/muaj në bazë të ligjit organik.
 - 2) Niveli i II-të (dytë): Inxhinieri Hidroteknik në momentin e përfitimit të Krediteve i lind e drejta të kërkojë dhe do të paguhet minimalisht me pagën (bruto) + Vlerën e Krediteve (bruto), si edhe përfiton nga çdo punëdhënës fee, për të drejtën e përdorimit të titullit Inxhinier Hidroteknike, përkatësisht shumen prej 10.000 leke/muaj në bazë të ligjit organik.
 - 3) Niveli i I-rë (parë): Inxhinieri Hidroteknik i kualifikuar në nivelin e I-re, për rivlerësimin e Krediteve i lind e drejta të kërkojë dhe do të paguhet minimalisht me pagën (bruto) + Vlerën e

Krediteve (bruto) te Nivelit te II-te + Vlerën e Krediteve (bruto) ne vazhdimësi te Nivelit te I-re. Si edhe përfiton nga çdo punëdhënës fee, për te drejtën e përdorimit te titullit Inxhinier Hidroteknike, përkatësisht shumen prej 10.000 leke/muaj ne baze te ligjit organik, ose për te drejtën e përdorimit te titullit Urdhri Profesional Hidroteknike, përkatësisht shumen prej 25.000 leke/muaj ne baze te ligjit organik nëse përfiton këtë titull nga Urdhri.

- B. Nëpërmjet bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave, me propozimin e ministrit që administron çështjen e financës edhe të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, përcakton pozicionin në grup dhe pagën minimale referuese të kategorisë të specialistëve dhe nën specialistëve plotësues në veprimtarinë hidroteknike dhe të reagimit emergjent.
- C. Metodologjia e përlllogaritjes së tarifës së shërbimit, llojet e shërbimeve për kryerjen e aktivitetit në fushën e veprimtarisë hidroteknike përgatiten nga Kryesia e Urdhrit në përputhje me legjislacionin në fuqi, si edhe dispozitave që parashikohen në ligjin organik, dhe miratohet me vendim të Asamblesë Kombëtar të Urdhrit.

Objektivi Nr. 6.

Zgjidhjes se konflikteve profesionale nga Urdhri, do te behet nëpërmjet procedurës se gjykimit profesional. Pranë Urdhrit do te funksionoj Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, si organizëm i gjykimit profesional dhe do te shqyrtoj kërkesat për ankim të shërbimit profesional të karakterit teknik në fushën e veprimtarisë hidroteknike, lidhur me shërbimin e kryer për “Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, për “Vlerësim dhe Ekspertizë Teknike”.

- A. Detyra kryesore e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional, në përmbushje të objektit të punës së tij lidhur me shqyrtimin e ankesës ndaj shërbimit të bërë sipas ligjit, është të kontrolloj:
- a) përputhshmërinë me detyrën;
 - b) rregullshmërinë e kushteve teknikë;
 - c) ligjshmërinë për zhvillimin e qëndrueshëm të projektit;
 - ç) sigurinë dhe shëndetin publik.

Komisioni i Ankimit të Shërbimi Profesional zbaton procesin e rregullt ligjor dhe nxjerr aktet administrative në bazë dhe zbatim të ligjit të Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Procedurave (Kodit) Civil në Republikën e Shqipërisë, normave teknike dhe referencave përkatëse të miratuara paraprakisht nga urdhri, si edhe të ligjit organik. Akti Administrativ (shërbimi), përbën titull ekzekutiv

Objektivi Nr. 7.

Ndikimi ne evazoni profesional dhe evazonin fiskal, ndaj çdo sjelljeje ose veprimi të inxhinierëve hidroteknik apo personave fizikë/juridik si edhe specialistëve të nivelit jo inxhinier, si edhe personave jo kompetent në fushën e veprimtarisë hidroteknike, i drejtohen ankesa ose kërkesa Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Për shqyrtimin e kërkesave/ankesave për procedim administrativë, pranë Urdhrit funksionon Komisioni Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjykimit disiplinor profesional.

- A. Detyrat kryesore të Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional, në përmbushje të objektit të punës së tij, janë:
- a) të shqyrtojë ankesë/kërkesat sipas fazave të verifikimit, të refuzimit dhe gjykimit, sipas parashikimeve në ligji;
 - b) mbikëqyrë zbatimin e statutit, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, kodeve dhe rregulloreve teknike të Urdhrit, sipas përcaktimeve në ligji;
 - c) kryen procedurë administrative dhe për shkeljet vendos masa disiplinore:
 - i. dënim me gjobë,
 - ii. dënim i natyrave të tjera.
 - ç) kryen procedurë administrative për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave/kërkesave të vendimeve të Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional të Urdhrit.

Objektivi Nr. 8.

Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ne RSH nëpërmjet inxhinierëve hidroteknike synon te nxisë dhe te inkurajoj dhe te rekrutoj student me qellim edukimin e nivelit te mesëm dhe te larte universitare ne inxhinierinë hidroteknike. Inxhinieri Hidroteknik ka për detyrim te trashëgojë profesionin.

- A. Inxhinieret hidroteknike te nivelit te pare dhe te trajnuar dhe certifikuar si Lektor kane detyrim te rekrutojnë minimalisht një student ne vite.

3) IDENTIFIKIMI I ZONAVE TE RISKUT NE KUADER TE FUSHAVE TE VEPRIMTARISE

"Risk" është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të shoqërisë së inxhinierisë hidroteknike.

Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut janë të lidhura ngushtë me realizimin e qëllimeve të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik në RSH.

Në çdo veprimtari njerëzore risku është bashkëshoqërues i përhershëm në fushën e disiplinës hidroteknike, d.m.th. një barrierë, pengesë, me dëme, me rreziqe, etj., që ndikojnë negativisht te inxhinieri hidroteknik i cili ka lidhur jetën në ushtrimin e profesionit të inxhinierit hidroteknike.

Identifikimi i zonave të riskut në kontekstin e fushës së veprimit të Urdhrit konsiston në përcaktimin e risqeve, mbështetur në ndarjen e risqeve:

1) risqe të brendshme dhe risqe të jashtme;

Faktorët e brendshëm rrjedhin nga mënyra e menaxhimit dhe përfshijnë strukturën, kompetencat, aftësitë si dhe mënyrën se si funksionojnë sistemet e informacionit.

Faktorët e jashtëm përfshijnë, por nuk kufizohen në faktorë që derivojnë nga ndryshimet e ambientit politik, social e teknologjik dhe problemet ekonomike që ndikojnë si mbi vetë Urdhri ashtu dhe në subjekte që kryejnë shërbime të inxhinierisë.

2) risqet në nivel subjekti dhe në nivel detyrash.

Risku me kryesor është në nivel subjekti dhe në nivel detyrash dhe është Karta Teknologjike ose ndryshe guri i themelit të shërbimeve hidroteknike.

Karta Teknologjike është një udhërrëfyes për çdo inxhinier apo shoqëri inxhinierie hidroteknike në aktivitetin administrativ dhe profesional të tyre në kryerjen e shërbimeve në fushën e veprimtarisë hidroteknike.

Ky akt administrativ përmban, një skemë me rregulla të sakta e të qarta për çdo element të skemës menaxheriale për çdo objekt shërbimi në veprimtarinë e disiplinës së inxhinierisë hidroteknike.

Në brendësi ky dokument do të përfshijë tre elemente të rëndësishëm:

- a) Skemën e menaxhimit dhe pjesët përbërëse të saj, sipas veçorive të aktivitetit që kryet:

- b) Detyrat dhe përgjegjësitë për çdo elemente të skemës ku përfshihen edhe përgjegjësitë e urdhrit. Në këtë mënyrë saktësohen kompetencat dhe kontrolli mbi veprimtarinë bëhet më eficient e konkrete duke shmangur subjektivitetin në gjykim, vendime dhe veprime;
- c) Detyrat dhe përgjegjësitë e inxhinierit hidroteknike, dhe që duhet të jenë konkrete, të kontrollueshme dhe me shkallë vlerësimi.

4) PERKUFIZIMI DHE PERSHKRIMI I RISKUT

Ky moment kyç përfshin procesin e identifikimit të risqeve të njohura gjerësisht, por edhe të risqeve të reja. Analiza ka për qëllim përshkrimin e riskut kaq mirë, sa që të jetë i mundur vlerësimi i tij si dhe përzgjedhja e veprimeve të duhura.

Risqet mund të klasifikohen në këndvështrimin e objekteve ngjarjeve, deklaratave, etj., por edhe të subjekteve (grupet e personave, ose të subjekteve).

Mund të dallojmë disa faktorë të riskut, që kanë ndikim në rezultatin e analizës, p.sh.:

- situata financiare e subjektit që kryen shërbimin si edhe vete urdhrit;
- numri i Hidroteknikëve dhe kualifikimet e tyre;
- çështje të etikës së sjelljes dhe e deontologjisë së Hidroteknikeve;
- presionet e jashtme mbi subjektin (p.sh., politike, ose kriminale), etj.;
- numri, lloji dhe madhësia e operacioneve financiare të kryera,
- cilësia e normave teknike dhe akteve nënligjore;
- ndryshimet në mënyrën e veprimit, ndryshimi i strukturës organizative, lëvizja e personelit;
- ndryshimet e sistemeve informatike,
- rezultatet dhe koha që ka kaluar nga kontrolli i kryer më herë mbi njësinë, apo auditimi i saj,
- kushtet e punës në subjekt.

Në mënyrë që identifikimi i riskut të jetë objektiv, i thelluar dhe në një perspektivë afat-gjatë, të karakterizohet nga marrja sistematike dhe me një logjikë të caktuar e masave të ndryshme, duhet të respektohen parimet e mëposhtme:

- 1) identifikimi i riskut duhet të kryhet nga një ekip pune i posaçëm, nga anëtarët e urdhrit që kanë ndikim drejtpërdrejtë;
- 2) puna për këtë detyrë duhet të zhvillohet sistematikisht dhe me plan,

- 3) prioritet duhet të konsiderohen kriteret bazë (p.sh. arritja e qëllimeve më të rëndësishme),
- 4) identifikimi i riskut duhet të kryhet në lidhje të ngushtë me zonat e riskut.

Duhet të merren gjithashtu parasysh faktorët, që e favorizojnë lindjen e një risku të caktuar, si p.sh:

- dështimet në arritjen e qëllimeve në të kaluarën, mosrealizimi i detyrës, ose qëllimit, tejkalimi i shpenzimeve të planifikuara, mosrealizimi i planit të të ardhurave;
- parregullsi në të shkuarën: shpenzime të parregullta, cënimi i procedurave, shkelja e ligjit, ose e rregulloreve të brendshme, e rekomandimeve të Urdhrit, etj.
- faktorët e riskut të lindur (të brendshëm): karakteri i veprimtarisë, madhësia e subjektit, numri i punonjësve, madhësia e pronës së paluajtshme, numri i transaksioneve, specifikat e territorit ku zhvillon aktivitetin, etj.

5) ANALIZA E IMPAKTIT TE RISKUT

Duke analizuar impaktin e një risku të caktuar, duhet të kemi parasysh se ky proces ka karakter vlerësimi subjektiv të kryer nga një grup inxhinieresh hidroteknike, ose nga Urdhri.

Përcaktimi i impaktit të një risku të dhënë duhet të mbështetet në shkallën e mëposhtme të impaktit:

- **I lartë:** zgjidhja e problemit do të kërkojë shumë kohë/burime. Shmangja e pasojave do të jetë shumë e vështirë, ndoshta e pamundur. Ai do të ketë ndikimi thelbësor mbi Urdhrin dhe do të përbëjë një ngjarje të rëndësishme publike.
- **Mesatar:** zgjidhja e problemit do të kërkojë një kohë/burime mesatare. Shmangja e pasojave do të kërkojë kohë. Mund të ndodhë që të bëhet ngjarje publike.
- **I ulët:** zgjidhja e problemit do të kërkojë kohë, por problemi nuk do të shkaktojë dëme të përhershme. Nuk do të bëhet ngjarje publike.

6) PERCAKTIMI I PROBABILITETIT QE RISKU TE NDODH

Duke analizuar probabilitetin që një risk i caktuar të ndodhë, duhet të kemi parasysh gjithashtu se ky proces ka karakterin e një vlerësimi subjektiv, të kryer nga një grup inxhinieresh hidroteknike, ose nga Urdhri.

Pranohet se probabiliteti është:

- **I lartë:** atëherë, kur ka më shumë se 60% të gjasave se risku do të ndodhë, vetëm nëse ky nuk do të zvogëlohet (ose risku do të kristalizohet në formë sistematike, ose rutinë).
- **Mesatar:** kur gjasat janë më të larta se 10%, por më të ulëta se 60%, se risku do të ndodhë, vetëm nëse nuk zvogëlohet (ose risku të kristalizohet ose për shkak të koincidencave të jashtëzakonshme, ose rastësisht),
- **I ulët:** kur gjasat janë më të ulëta se 10%, se risku do të ndodhë, vetëm nëse ai nuk zvogëlohet (ose risku do të kristalizohet rrallë, shfaqjet e tij do të jenë të izoluara).

Grupimi i risqeve sipas impaktit dhe probabilitetit të tyre, duhet t'i japë mundësinë Kryesisë se Urdhrit që të përcaktojë drejtimet parësore në marrjen e masave riparuese si dhe të nxjerrë në pah kërcënimet reale në realizimin e detyrave dhe qëllimeve të subjektit.

7) PERGJIGJA NDAJ RISKUT

Duke përshkruar si masat e marra tashmë, ashtu edhe ato të planifikuara, me karakter riparues, duhet mbështetur në dokumentet dhe në rregulloret e Urdhrit të karakterit normativ, të tilla si vendime për inxhinierët hidroteknikë, si edhe urdhrat e titullarit apo porositë me shkrim që i janë drejtuar stafit të punës, por edhe tek masat e realizuara faktikisht që janë marrë deri më tani në segmente të ndryshme të punës së Urdhrit.

Nëse analiza e kryer tregon se masat e marra deri më tani, janë të pamjaftueshme për minimizimin e një risku të caktuar, atëherë duhet të shqyrtohen dhe të pranohen procedurat dhe zgjidhje të reja, të cilat e shtyjnë riskun në një nivel më të ulët probabiliteti. Por gjithashtu duhet mbajtur mend se përgjigja ndaj riskut mund të marrë forma të ndryshme:

- **transferimi** – kalimi i riskut tek një subjekt tjetër,
- **tolerimi** – mundësitë e kufizuara për veprim, p.sh. veprimet e kufizuara deri në minimumin e kërkuar nga fusha e kompetencave, apo nga akti ligjor, që ngarkon përmbushjen e qëllimeve të caktuara; kosto të larta të pasojave të mundshme të kristalizimit të një risku të caktuar (mbikëqyrja e domosdoshme dhe monitorimi i nga Urdhri apo vete Urdhërit);
- **veprimi** – grupi më i shumtë, qëllimi: dobësimi i riskut deri në nivelin e pranueshëm, veprimet e ndërmarra në njësi, të përfshira nga kontrolli i brendshëm, i cili i atribuohet një nivel të caktuar drejtimi, në përputhje me nivelin e kompetencave dhe me nivelin e impaktit të një risku të caktuar.

☐ **PLANI VJETOR**

☐ **IDENTIFIKIMI I RISKUT**

☐ **VLERESIMI OREKSI PER RISK**

☐ **PERGJIGJA NDAJ RISKUT**

8) CAKTIMI I DETYRAVE KONKRETE LIDHUR ME KUNDERVEPRIMIN NDAJ NJE LLOJI TE CAKTUAR RISKU

Caktimi i detyrave konkrete duhet të bëhet sipas një qëllimi dhe logjike të caktuar, në lidhje me planin vjetor të punës si dhe rregulloret dhe udhëzimet e brendshme që rregullojnë fushën e veprimit të strukturave sipas ligjit organik dhe të punonjësve të tyre.

Duhet të udhëhiqemi gjithashtu nga parimi i evitimit të shkrirjes së përgjegjësive nëpërmjet ngarkimit të një detyre, një grupi tepër të madh punonjësish.

Pas përmbushjes së kësaj etape të procesit të analizës dhe menaxhimit të riskut, duhet të kryhet një përmbledhje sistematike e konstatimeve, përfundimeve dhe synimeve të deritanishme, në formë tabele, sipas modelit të mëposhtëm:


TABELA PERMBLEDHES

NR	IDENTIFIKIMI I RISKUT	ANALIZA E RISKUT	PERGJIGJA NDAJ RISKUT						
	Fusha e Veprimi	Fusha e Riskut	Përshkrimi i Riskut	Impakti i Riskut	Probabiliteti i Riskut	Masat e Marra	Masat e Planifikuara	Personat Përgjegjës për realizimin e tyre	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	

9) KRIJIMI I HARTES SE RISKUT

Hartimi i një diagrami që grupon risqe të ndryshme sipas impaktit të tyre, në raport me probabilitetin që ato të ndodhin (pra të hartës së riskut) është metoda më e thjeshtë, që tregon në formë grafike, ato fusha të veprimtarisë së Hidroteknikes, për të cilat duhet të tregojë vëmendje të veçantë Urdhri i Inxhinierëve Hidroteknike. Harta e risqeve përftohet sipas modelit të mëposhtëm:

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E RISKUT



III.	II.	I.
VI.	V.	IV.
IX.	VIII.	VII.


Harta e riskut përcakton zonat e riskut, me peshë dhe impakt të ndryshëm.

Mund të veçohen 9 zona të tilla:

- I. zona me prioritet absolut, që kërkon kontrollin permanent të Urdhrit,
- II. zonë me rëndësi të madhe, që kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme,
- III. zonë me rëndësi të madhe, por ka pak të ngjarë të ndodhë – kontrolli ciklik
- IV. zonë me rëndësi të madhe që kërkon kontroll të vazhdueshëm nga ana e nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit,
- V. zonë me rëndësi, që kërkon mbikëqyrje ciklike të nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit,

- VI. zonë potencialisht e rëndësishme, por me pak probabilitet që të ndodhë,
- VII. zonë kërcënimesh jo shumë të rëndësishme, që kërkon monitorimin në nivel punonjësish,
- VIII. zonë kërcënimesh pak të rëndësishme që kërkon vetëm mbikëqyrje sporadike dhe raportim në periudha kohore të distancuara nga njëra-tjetra.
- IX. zonë kërcënimesh thuajse të parëndësishme.

VLERËSIMI I RISKUT



10) MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Është kjo një etapë që i jep titullarit të Urdhrit liri të plotë në përzgjedhjen dhe vlerësimin e mjeteve dhe metodave të mbikëqyrjes mbi procesin e menaxhimit të riskut. Kjo liri është megjithatë e kushtëzuar nga dy metoda themelore për garantimin e një kontrolli efektiv të risqeve.

Këto janë:

- Sistemi i raportimit: Grupi për Çështjet e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm, njëherë në gjysmë viti përgatit një informacion me shkrim lidhur me punën e grupit, të cili ia përcjell titullarit. Përveç kësaj, në situata kur ndodhin ngjarje të caktuara, të cilat kanë ndikim tek Menaxhimi i Riskut të Brendshëm, çdo punonjës ka detyrimin për të informuar lidhur me këtë fakt Koordinatorin e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm ose, eprorin e tij të drejtpërdrejtë. Në rastin e informimit të eprorit të drejtpërdrejtë, ky i fundit ka detyrimin të informojë lidhur me sa më sipër Koordinatorin.
- Auditimi i brendshëm, që kryhet nga struktura e posaçme në Urdhër.

DISPOZITA MIRATUESE

HYRJA NE FUQI

PLANI I STRATEGJISE DHE MENAXHIMI I RISKUT

hy ne fuqi me njëherë me datën 2020

NDRYSHIMI I AKTIT

Çdo ndryshim ne PLANIN E STRATEGJISE DHE MENAXHIMI I RISKUT do te duhen te paktën 2/3 e votave te anëtarëve te Asamblesë Kombëtare.

REZULTATI I VOTIMIT

VOTIMI U BE I: HAPUR me orën date

MIRATOHET ME PROCESVERBALIN PERKATES

REZULTATI I VOTIMIT:

Numri i Anëtarëve:

Prezenca:

Votues:

Votuan **PO** :

Votuan **KUNDER** :